



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:251722

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05742566

**P.nr.358/21**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me bashkëpunëtorin profesional Ismajl Kuçi në çeshtjen penale ndaj të pandehurve: I.S nga Kaçaniku, K.G dhe A.G, nga fsh....-Kaçanik, të akuzuar për veprën penale në bashkryerje, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1715/21 të datës 22.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.15.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit, Ardian Emini, të pandehurit I.S, me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, av. Flamur Troni, të pandehurit K.G, me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, av.Driton Rudi dhe të pandehurit A.G, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.Shefket Cani, me dt.17.05.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.05.2024 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### Të pandehurit:

**1.I.S nga Kaçaniku**, i lindur më dt...., nga i ati A... dhe e ëma K..., e gjinisë S... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

**2.K.G nga fsh....-Kaçanik**, i lindur më dt...., nga i ati N... dhe e ëma A..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

**3.A.G nga fsh....-Kaçanik,** i lindur më dt....., nga i ati N... dhe e ëma A..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

## JANË FAJTORË

Sepse me dt.08.11.2021 rreth orës 19:00, në rrugën “Ismajl Raka” në Kaçanik, të pandehurit I.S, K... dhe A.G, në bashkëkryerja e më dashje që t’u shkaktojnë lëndime trupore, të dëmtuarve L.B, A.K dhe të miturit F.K, në atë mënyrë që të pandehurit, K... dhe A..., me mjet që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor-shkop drurit, e godasin të dëmtuarin L.B në kraharorin e majtë dhe përreth syrit të djathtë, ku për pasojë e goditjeve i dëmtuari ka pësuar lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme të shëndetit, në formë ndrydhje në parakrahun e majtë dhe ndrydhje përreth orbitës së djathtë, të dëmtuarin F..., e godasin me mjet që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor-shkop drurit në kokë, si pasojë e goditjeve i dëmtuari ka pësuar lëndim të lehtë trupor në formë plagë shqyese në pjesën murore te kokës, ndërsa i pandehuri I., të dëmtuarin A..., e godet me mjet që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor-thikë në kokë, në kraharorin e djathtë të dorës dhe gishtin e 2 tregues të dorës së majtë, si pasojë e goditjeve i dëmtuari ka pësuar lëndim të lehtë trupor, në formë të plagë prerëse në pjesë zverkore të kokës, ne regjionin nenshpattullor dhe gishtin e 2 tregues të dorës së majtë.

Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së, nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, i

## GJYKON

**Të pandehurin I.S,** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, në të cilin do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 08.11.2021 deri me dt.07.12.2021, ndërsa pjesa tjetër do t’i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 600.00€.

**Të pandehurin A.G**, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, në të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 08.11.2021 deri me dt.07.12.2021, ndërsa pjesa tjetër do t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 600.00€.

**Të pandehurin K.G** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, në të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 08.11.2021 deri me dt.07.12.2021, ndërsa pjesa tjetër do t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 400.00€.

Të pandehurit secili veq e veq, janë të obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajnë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ne afatin prej 30 ditësh, por jo më gjatë se dy muaj pas plotfuqishmerise së këtij aktgjykimi dh ate në tri këste.

Nëse të pandehurit nuk e paguajnë gjobën, gjykata do t'a zevendesoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohen të pandehurit, secili veq e veq, që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguajnë pranë kësaj gjykate, shumën prej 10.00€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20€, ndërsa në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave te Krimin shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Të dëmtuarit: L.B, A.K, dhe F.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1715/21 të datës 22.12.2021 të pandehurit: I.S nga Kaçaniku, K.G dhe A.G, nga fsh....-Kaçanik, I ka akuzuar për veprën penale në bashkryerje, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, ndërsa të pandehurit: L.B dhe A.K nga Kaçaniku, I ka akuzuar për veprën penale në bashkryerje, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, dhe veprën penale në bashkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të gjykoen sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.05.09.2022 me te cilin rast, pas prezentimit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit: L.B dhe A.K, e kanë pranuar fajësinë për veprën penale në bashkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, në bashkryerje, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, kurse të pandehurit: I.S, K.G dhe A.G, nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale në bashkryerje, Lëndim i lehtë trupor nga neni trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 14.05.2024, pasi që gjykata konstatoi se plotësohen kushtet ligjore, konfor nenit 35 par.1 të KPP-së, veqoi procedurën penale, fillimisht ndaj të pandehurit A.K.

Prokurori i shtetit Ardian Emini , me rastin e prezentimit të aktakuzës në shqyrtim gjyqësor, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate, pa plotësime dhe ndryshime.

I pandehuri L.B, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në bashkryerje, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, ndërsa të pandehurit: I.S, K.G dhe A.G, në fjalën e tyre, pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori I shtetit, e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën i ngarkon aktakuza, duke shprehur pendesë për veprimin e tyre dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla apo të ngjashme, nuk do të përsërisin në të ardhmen.

Prokurori I shtetit dhe mbrojtësit e të pandehurve, nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajesise nga ana e të pandehurve: I.S, K.G dhe A.G.

Pasi që, gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se të pandehurit: I.S, K.G dhe A.G, e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajesise, se pranimi i fajesise është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbeshtetet ne faktet e çeshtjes qe permban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike, aprovoi pranimin e fajësisë për të pandehurit: I.S, K.G dhe A.G, dhe konfor nenit 35 par.1 të KPP-së, veqoi procedurën penale edhe kundër të pandehurit, L.B. Derisa sa u përket të pandehurve: I.S, K.G dhe A.G, shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi I fajësisë nga ana e të pandehurve: I.S, K.G dhe A.G, të cilët vullnetarisht e pranuan fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurit t'i shpall fajtorë dhe t'u shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e tyre, ndërsa si rrethanë rënduese, cënimin e integritetit trupor të të dëmtuarve.

Mbrojtësi i të pandehurit I.S, av. Flamur Troni, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, pasi që i mbrojturi i tij, e pranoi fajësinë, I propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, të merret parasysh si rrethanë lehtësuese, pranimi I fajësisë, pendimi I të mbrojturit të tij, zotimi, I këtij të fundit, se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso veprime, mosha e tij e re, fakti që I njejt nuk është përsëritës I këtyre veprave penale, dhe nën këto rrethana, kërkon nga gjykata që ndaj të njejt të shqiptohet një dënim I kushtëzuar I cili do të arrinte qëllimin e dënimit, por nëse veq gjykata e sheh të arsyeshme që të pandehurit I..., t'I shqiptohet denim me burgim, I propozon gjykatës që dënimi me burgim të zëvendësohet me denim me gjobë, duke mundësuar pagesën me këste. Me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, pajtohet edhe I pandehuri I.S.

Mbrojtësi i të pandehurit K.G av. Driton Rudi në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, pasi që i mbrojturi i tij, e pranoi fajësinë, I propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, të merret parasysh si rrethanë lehtësuese, pranimi I fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimi I sinqertë I të mbrojturit të tij, faktin se I njejt për here të pare ka rënë në kundërshtim me ligjin, sjelljen korrekte, përkatësisht bashkëpunimin vullnetar me organet e drejtësisë si dhe faktin se tani më I mbrojturi I tij I ka zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet bashkë edhe me të pandehurit tjerë, Prandaj bazuar në të lartëcekurat, I propozon gjykatës që ndaj të njejt të shqiptohet një dënim I kushtëzuar, por nëse veq gjykata nuk e sheh të arsyeshme shqiptimin e dënimit me kusht, I propozon gjykatës që dënimi me burgim të zëvendësohet me denim me gjobë, duke mundësuar pagesën me këste, të cilat mos të jenë më të larta se paga minimale në Rep. e Kosovës. Me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, pajtohet edhe I pandehuri K.G.

Mbrojtësi i të pandehurit A.G av. Shefket Cani në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, pasi që i mbrojturi i tij e pranoi fajësinë, I propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, të merret parasysh si rrethanë lehtësuese, pranimi I fajësisë nga ana e të mbrojturit të

tij, pajtimin e palëve mes veti dhe faktin se I mbrojturi I tij, ka qenë I detyruar që të zbraps sulmin nga vetja e tij, dhe poashtu ka kërkuar nga gjykata, që me rastin e vlerësimit të rrethanës, nëse I mbrojturi I tij, ka qenë I gjykuar më parë, të ketë parasysh se vepra penale a ka qenë e llojit të njejtë, dhe mos të merret si rrethanë rënduese vetëm fakti që I mbrojturi I tij ka rënë ndesh me ligjin meqë sipas tij, vetëm ndeshja me ligjin nuk nënkupton domosdo rrethanën rënduese. Sa I përket sanksionit penal, mbrojtësi I propozon gjykatës, që të shqiptohet denim me gjobë I kushtëzuar me afat verifikimi jo më gjatë se dy vjet dhe që lartësia e gjobës të jetë duke u bazuar në gjendjen ekonomike të tij dhe mundësi pagese me këste. Me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, pajtohet edhe I pandehuri A.G.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve: I.S,K.G dhe A.G, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale në bashkryerje, Lëndim I lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 te KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se të pandehurit secili veq e veq, e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën i ngarkon pika II e aktakuzës, në seancën e parë të shqyrtimit gjyqesor, kanë premtuar,secili veq e veq, para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprime te tilla, faktin se bazuar në evidencën e gjykatës, si të rritur nuk kanë patur ndonjë rast tjetër penal, përveq këtij rasti, dhe faktin se lidhur me këtë rast ata kanë arritur të pajtohen me të dëmtuarit, ndërsa për të pandehurin K.G, gjykata ka parasysh edhe faktin se, I njejtë si pasojë e konfliktit fizik, ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese, për të tre të pandehurit, gjykata gjeti numrin e viktimave, meqë si pasojë e konfliktit, janë lënduar nga ana e të pandehurve tre persona.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurit: I.S, K.G dhe A.G, të akuzuar për veprën penale në bashkryerje, Lëndim i lehtë trupor nga neni trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurve dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e të pandehurve, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek të pandehurit dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEGA KAÇANIK**  
**P.nr.358/21 datë 27.05.2024**

Bashkëpunëtori profesional  
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.